

URDHËR
Nr. 580, datë 13.12.2019

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
JOPUBLIK TË NIVELIT TË ARSIMIT BAZË DHE TË ARSIMIT TË MESËM
TË LARTË, “DRITA E DITURISË”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikave 3 dhe 7 të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësishë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, dhe të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të nivelit të arsimit bazë dhe të nivelit të arsimit të mesëm të lartë, “Drita e Diturisë”, Tiranë, licencuar me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, nr. 295, datë 5.10.2000, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik” dhe me urdhër nr. 48, datë 2.3.2001, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”.

2. Subjekti “Drita e Diturisë” sh.p.k., me administratore znj. Pranvera Hackaj, e cila ka administruar institucionin arsimor jopublik “Drita e Diturisë”, Tiranë, ka këto detyrime:

a) Të vendosë në dispozicion të Zyres Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, çdo informacion të kërkuar.

b) Subjekti “Drita e Diturisë” sh.p.k., me administratore znj. Pranvera Hackaj, të depozitojë menjëherë, pranë Arkivit Shtetëror Vendor Tiranë, të gjithë dokumentacionin e shkollës, sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë ka për detyrë të monitorojë procesin e dorëzimit të dokumentacionit nga subjekti “Drita e Diturisë” sh.p.k. dhe të raportojë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e saj të varësisë të njohin veprimtarinë e kryer dhe dokumentacionin e lëshuar nga institucioni arsimor jopublik “Drita e Diturisë”, deri në datën 16.9.2017.

5. Urdhrat e ministrit përgjegjës për arsimin, me nr. 295, datë 5.10.2000, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik” dhe nr. 48, datë 2.3.2001, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”, shfuqizohen.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në MASR, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe subjekti, “Drita e Diturisë” sh.p.k., Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË**
Besa Shahini